

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

I.Kuadri Kontabel i Aplikuar.

Pasqyrat financiare te periudhes 01.Janar.2018-31.Dhjetor.2018, ne perberje te cilave jane Bilanci,Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve,Pasqyra e Fluksit te Parase,Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital ne date te mesiperme jane pergatitur ne baze te kerkesave te Ligjit nr.9228 date 29.04.2004*Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*,nenet 4 deri 18 te ketij ligji dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te vendit tone.

Bilanci ne perberje te pasqyrave financiare tregon pozicionin financiare(aktivet,pasivet dhe kapitalin) te Shoqerise *EnBi POWER* shpk me date 31.12.2018.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon perfomancen ekonomike(te ardhurat,shpenzimet dhe fitim/humbjen)te Shoqerise * EnBi POWER *shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave(Arketimet dhe pagesat ne para dhe ekuivalentet e saj) te Shoqerise* EnBi POWER *shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital neto tregon ndryshimet ne kapitalin e Shoqerise

* EnBi POWER * shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perparesise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
- Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
- Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

II . Politikat kryesore kontabele.

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te aplikuar ne Pasqyrat financiare jane sa me poshte:

2.1. Mjetet Monetare.

Per Mjetet monetare ne arke dhe ne banke eshte aplikuar politika konatabel e vlersimit *Vlera e drejte * ,sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.3.

Mjetet monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise qe daton 31.12.2018.

2.2. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.

Per Aktivet e Tjera financiare Afatshkurtera te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika konatabel e vlersimit *Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem* ,sipas paragrafit nr.26,27 te SKK-se nr.3.Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

2.3. Inventari

Per Inventarin e paraqitur ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika konatabel e vlersimit *Kosto historike*,sipas paragrafit nr.14,15 te SKK-se nr.4. Kostoje eshte llogaritur duke perdorur Metoden e mesatares se Ponderuar.

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

2.4. Aktivet Afatgjata Materiale.

Njohja dhe Matja :Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM-ve qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me koston e marrjes ose te prodhimit te tyre.Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e aktiveve ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Njohja Mepashme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvleresimi.

Në se një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi:Per llogaritjen e amortizimit te AAM-ve njesia ekonomike ka percaktuar si metode normat fiskale per amortizimin e asetëve.

Llojet e Aktiveve te Qendrueshme	Normat e aplikuar	Metoda e aplikuar
Makineri dhe pajisje	20%	Me vlere te mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlere te mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlere te mbetur
Te tjera	20%	Me vlere te mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me vlere te mbetur

Llogaritja e amortizimit te AAM-ve te hyra gjate vitit behet duke filluar nga data e muajit pasardhes.

Tokat dhe Investimet ne process nuk amortizohen,

Ç`regjistrimi:Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk pritet me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysht ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

Zhvleresimi (Renia ne vlere):Shoqeria nuk vlereson ne daten raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet.

a) Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivt afatgjata jomateriale perfshijne licensat, te drejtat per perdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Licensat, te drejtat e perdorimit te cilat perftohen nga shoqeria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi, nese ka.

Shpenzimet Mëpasshme:Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.

Per Aktivt Afatgjate JoMateriale te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit *Kosto historike minus amortizimin e akumuluar ne vite* ,sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.5.

Amortizimi I AAJoM eshte llogaritur sipas metodes te percaktuar ne Ligjin 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" .

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

2.7.Huat dhe parapagimet.

Per Huat dhe parapagimet te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem * ,sipas paragrafit nr.32,33 te SKK-se nr.3. Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

2.8.Huamarrje te tjera afatgjata.

Per Huamarrjet e tjera Afatgjata te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit * Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem * ,sipas paragrafit nr.32,34 te SKK-se nr.3.

2.9.Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel.Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat I ndonje SKK-je.

2.10.Te Ardhurat dhe Shpenzimet.

Vleresimi I te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndidhjes.Vleresimi I tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35-37 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

2.11 *Konvertimi ne Monedha te Huaja*

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj në datën e hartimit të bilancit

2.12 *Krahasueshmëria*

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Te dhenat krahasuese pasqyrojne gjendjen e pozicionit finaciar te shoqerise ne 31 Dhjetor 2018.

Shoqëria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

2.13 Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë te shoqërise përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Njohja Fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Njohja e Metejshme

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

- *Paraja dhe Ekuivalentet*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvleresimet.

- *Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme*

Llogarite e arketueshme tregetare dhe te tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerë nominale te pakesuar nga zbritjet e nevojshme per shuma qe jane vleresuar te pambledhshme. Vleresimi i shumave te pambledhshme bazohet ne gjykimin e Drejtimit.

- *Llogari të Pagueshme*

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv .

- *Huatë të Dhëna dhe të Marra*

Huate e Dhena: Huate e arketueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuar ne nje treg aktiv. Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifate ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit (NEI). Efekti i tyre perfshihet ne rezultatin financiar.

Huate e marre: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me vlerën e amortizuar. Shpenzimet interesi te llogaritur me normen interesit efektive (NEI) pasqyrohen ne rezultat..

Norma e interesit efektive eshte norma që skonton saktesisht vlerat e ardhshme te parave gjate viteve te planifikuara te detyrimit financiar ose kur eshte e pershtatshme, ne nje peridhe me te shkurter.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kerkojne domosdoshmerish nje periudhe te madhe kohe per t'u bere gati per perdorimin e tyre perfundimtar ose per shitje mund ti shtohen koston se ketyre aktiveve deri ne momentin qe keto aktive jane kryesisht gati per tu perdorur ose shitur.

- *Netimi i Instrumentave Financiare*

Aktivet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet ne bilanc nese, dhe vetem nese ka nje te drejte te detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe ekziston mundësia

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

per të shlyer në shumen neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njekohesisht.

- *Zhvleresime te Aktiveve Financiare*

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje (pas njohjes se tij fillestare) kane efekte negative ne flukset e ardhshme te parase që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Veshtiresite e konsiderueshme financiare te debitorit, propabiliteti qe debitori do te falimentoje apo nje riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet ne pagesa konsiderohen si tregues qe nje llogari e arketueshme eshte e zhvleresuar.

- *Çregjistrimi*

Aktivitetet financiare se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- *Transaksionet me palet e lidhura*

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter.

2.14 Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te tërthorte) si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar per te cilen ka mundesi qe te krijohen nje rrjedhe burimesh te nevojshme per te permbushur detyrimin dhe kur nje perlllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit mund te llogaritet. Provigjionet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi per nevojen e nje rrjedhe burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht.

Pasivet dhe aktivet e kushtezuara nuk njihen, por vetem paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare te ndermjetme kur jane materiale.

2.15 Qiratë

Qirate klasifikohen si qira financiare ose qira operative qe ne fillim te qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me me te voglen midis vleres se drejte te aktivitetit dhe vleres aktuale te pagesave minimale te qirase ne daten e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencen midis detyrimit total te qirase dhe vleres se drejte te aktivitetit. Kostot financiare regjistrohen ne pasqyren te te ardhurave & shpenzimeve gjate kohezgjatjes se qirase me norma interesi te aplikueshme mbi balancen e mbetur te detyrimeve.

2.16 Inventaret

Inventaret regjistrohen ne konatibilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e inventarit ne vendin e percaktuar. Ne rastin e prodhimit te produkteve, ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda e koston mesatare te ponderuar.

2.17 Të Ardhurat & Shpenzimet

- *Te Ardhurat*

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. Te ardhura matet me vlere te drejte te mallit/sherbimit te shitur neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

- *Shpenzimet*

Shoqeria njih shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me kryerjen e tyre ne daten e raportimit. Shpenzimet paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyres se tyre, çka kerkon gjykim te konsiderueshem nga drejtimi i Shoqerise.

- *Te Ardhurat dhe shpenzimet Financiare*

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metodën e interesit efektiv.

- *Tatimi mbi Fitimin*

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

2.18 Dividentet

Shoqeria synon te njohe dividentet si detyrim ne periudhen ne te cilen jane deklaruar.

2.19 Kapitali i Vet

Kapitali i nenshkruar perfaqeson kontributin e ortakeve në daten e krijimit të shoqerise dhe ndryshimet gjate veprimtarise.

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

2.20 Përfitimet e punonjesve

- *Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

2.21 Ngjarje pas mbylljes se Pasqyrave Financiare

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese te Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.

III. Informacion-Shtese per zerat Materiale.

I.A.A.1. Mjetet Monetare.

Gjendja e *Mjetet Monetare* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

TE TJERA SHENIMET			
Mjete monetare			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Para ne dore	920,664.4	34,694.9	885,969.5
Para ne Banka	496,458,179.3	363,643,637.6	132,814,541.7
Vlera arke (Pulle Akcize)	-	-	-
Totali	497,378,843.6	363,678,332.5	133,700,511.1

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten e fundit, 31.12.2018, e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe si dhe me gjendjen e arkës se Shoqerise ne fund muajit Dhjetor 2018.

I.A.A.3. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.

Gjendja e *Aktiveve te tjera Financiare Afatshkurtera* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Aktive te tjera afatshkurtra financiare			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
			-
Kerkesa te arketueshme	337,196,325.4	573,741,116.2	(236,544,790.8)
Kerkesa te tjera te arketueshme	16,405,859.7	1,937.4	16,403,922.3
Instrumente te tjera borxhi	123,124,526.7	95,566,953.7	27,557,573.0
Investime te tjera financiare	-	-	-
Totali	476,726,711.8	669,310,007.3	(192,583,295.5)

Aktivete Tjera Financiare Afatshkurtera krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar ulje per vleren 192,583,295.5 lek, ne strukture Kerkesat e arketueshme kane ulje ne vleren 236,544,790.8 leke dhe Kerkesat e tjera te arketueshme kane ulje ne vleren 16.403,922.3 leke dhe instrumenta te tjera kane rritje ne vleren 27.524.443 lek .

I.A.A.4. Inventaret.

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

Inventaret krahasuar me vitin e kaluar kane ulje ne vleren 7,716,490.3 leke,

Inventari			
	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Lendet e para	13,830,229.2	522,572.5	13,307,656.7
Prodhim ne proces	-	-	-
Produkte te gatshme	-	-	-
Mallra per rishitje	-	-	-
Parapagesat per furnizime	2,588,031.4	23,612,178.4	(21,024,147.0)
Totali	16,418,260.6	24,134,750.9	(7,716,490.3)

Inventari i *Stokut * paraqitet ne aneksin shtese .

II.A.A.2.Aktivet Afatgjata Materiale.

Gjendja e *Aktiveve Afatgjata Materiale* sipas grupimeve ne strukture me date 31.12.2018 paraqitet si me poshte:

Aktive afatgjata materiale			
	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Toka	37,755,280.0	37,755,280.0	-
Ndertesat	82,141,060.0	15,521,291.0	66,619,769.0
Makineri dhe pajisje	15,587,666.4	18,942,885.8	(3,355,219.4)
Aktive te tjera afatgjata materiale	17,238,671.3	19,609,127.3	(2,370,456.0)
Totali	152,722,677.7	91,828,584.1	60,894,093.6

Ne total *Aktivet Afatgjata Materiale* kane ritje neto ne vleren 60,894,093.6leke dhe peshen kryesore e ze ndertimi i magazines kurse shtesat,pakesimet,amortizimet dhe vlera e mbetur ose kostoja e amortizuar paraqitet ne analizat e Inventari kontabel i * Aktivet Afatgjata Materiale * paraqitet ne aneksin shtese

Gjendja e *Aktiveve Afatgjata Jo Materiale* sipas grupimeve ne strukture me date 31.12.2018 paraqitet si me poshte:

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

Aktivitet afatgjata jomateriale			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Emri i mire	-	-	-
Shpenzimet e zhvillimit	-	-	-
Aktive te tjera afatgjata jomateriale	8,982.0	11,975.0	(2,993.0)
Totali	8,982.0	11,975.0	(2,993.0)

II.A.A.1. Investimet financiare afatgjata.

Gjendja e *Investimet financiare afatgjata * sipas grupimeve ne strukture me date 31.12.2018 paraqitet si me poshte:

Investimet financiare afatgjata			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kor	-	-	-
Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	-	-	-
Aksione dhe letra te tjera me vlere	-	-	-
Kerkesa te arketueshme afatgjata	-	-	-
Totali	-	-	-

Investimet financiare afatgjata			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kor	-	-	-
Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	-	-	-
Aksione dhe letra te tjera me vlere	-	-	-
Kerkesa te arketueshme afatgjata	-	-	-
Totali	-	-	-

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

Ne total *Investimet financiare afatgjata * kane pakesim neto ne vleren 0 leke.

I.D.A..Detyrimet afatshkurtera.

Gjendja e *Detyrimet Afatshkurtera* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Detyrimet Afatshkurtra	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017	Ndryshimi +/-
Derivatet (vlera negative)	-	-	-
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	-	-	-
Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	-	-	-
Bono te konvertueshme	-	-	-
Te pagueshme ndaj furnitoreve	428,715,660.0	391,627,373.0	37,088,287.0
Te pagueshme ndaj punonjesve	4,414,845.6	4,055,864.6	358,981.0
Detyrimet tatimore	2,212,845.8	4,581,168.0	(2,368,322.2)
Hua te tjera	4,116,956.4	20,497,074.5	(16,380,118.1)
Parapagimet e arketuara	56,341,525.9	54,450,198.0	1,891,327.9
Grantet dhe te ardhurat e shtyra	-	-	-
Provizionet afatshkurtra	-	-	-
	495,801,833.7	475,211,678.1	20,590,155.6

Ne total te grupit rezulton se ka rritje detyrimesh per vleren 20,590,155.6 lek.Ka rritje detyrimesh per *Te pagueshme ndaj furnitoreve* per vleren 37,088,287 lek.Ka ulje detyrimesh per *Te pagueshme ndaj punonjesve* per vleren 358,981 lek dhe ulje per *Detyrimet Tatimore* per vleren 2,368,322.1 .Detyrime te tjera kane ulje 16,380,118.1 leke dhe parapagime kane ritje ne vleren 1,891,327.9 lek .

I.D.A.3.iii.Detyrimet Tatimore.

Gjendja e *Detyrimeve Tatimore* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

Detyrimet tatimore			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
			-
Tatim mbi fitimin	(16,403,922.0)	19,744,062.8	(36,147,984.8)
TVSH per tu paguar	1,329,039.8	337,155.0	991,884.8
Sigurimet Shoqerore e Shendetsores	801,585.0	874,332.0	(72,747.0)
Tatim dividenti	-	3,300,000.0	(3,300,000.0)
Tatim mbi e ardhurat personale	82,221.0	69,681.0	12,540.0
Tatime e taksa te tjera (makine)	-	-	-
Totali	(14,191,076.2)	24,325,230.8	(38,516,307.0)

Te analizuara sipas pozicionit ne bilanc detyrimet tatimore jane ne anekse shtese.

II.D.A..Detyrimet afatgjata.

Gjendja e *Detyrimeve Afatgjata* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Detyrimet Afatgjata			
	<i>31 Dhjetor 2018</i>	<i>31 Dhjetor 2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	-	-	-
Bonot e konvertueshme	-	-	-
Huamarrje te tjera afatgjata	118,919,391.2	157,905,508.3	(38,986,117.1)
Provizionet afatgjata	-	-	-
Grantet dhe te ardhura te shtyra	-	-	-
Totali	118,919,391.2	157,905,508.3	(38,986,117.1)

Detyrimet afatgjata jane me nje vlere me te ulet prej 38,986,117.1 leke krahasuar me vitin e kaluar .Ne strukture Detyrimet afatgjata perbehen kryesisht nga huate e marra .

I.K..Kapitali

Shoqeria * EnBi Power *shpk,Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

Kapitali	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017	Ndryshimi +/-
Aksionet e pakices	-	-	-
Kapitali qe i perket aksionareve te sh. meme	-	-	-
Kapitali aksionar	240,000,000.0	240,000,000.0	-
Primi i aksionit	-	-	-
Njesite ose aksionet e thesarit	-	-	-
Rezerva ligjore	10,000,000.0	10,000,000.0	-
Rezerva te tjera	231,095,875.9	14,319,239.5	216,776,636.4
Rezerva statuoere	-	-	-
Fitimet e pashpermdara	48,024,704.1	48,024,703.9	0.2
Fitimi/Humbja e vitit financiar	23,281,153.9	203,502,520.0	(180,221,366.1)
Totali	552,401,733.8	515,846,463.4	36,555,270.4

Kapitali ne strukturen e tij ka ndryshime ne *Fitim/Humbje te vitit financiar* ne vleren 36.555.270.4 lek qe ka lidhje me fitimin neto te realizuar ne vitin ushtrimor 2018 dhe transferimin e fitimit te vitit te kaluar ne Perfaqesine ne Kosove .

Kapitali i Aksionereve nuk ka ndryshime dhe kapitali zoterohet nga:

1.Aksioneri Tajar Bregasi me 100 % te Kapitalit Aksionar.

Ndryshimet dhe levizjet e kapitalit ne grup dhe ne dy vitet e fundit eshte dhene ne Pasqyren e Ndryshimeve ne Kapital.

I.K.8.Fitim/Humbja e Vitit Financiar.

Fitim/Humbja e Vitit Financiar 2018 eshte rezultante e Te ardhurave ushtrimore dhe Shpenzimeve ushtrimore.Ne pasqyren e meposhteme do te paraqitet formula e Fitim/Humbjes te Vitit Financiar ne dy periudhat e fundit ne krahasim:

Shoqeria * EnBi Power *shpk, Tirane

Shenime shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Periudha 1 Janar 2018 31 Dhjetor 2018

E vlefshme per SHENIMET			
Te ardhura	<i>31.12.2018</i>	<i>31.12.2017</i>	<i>Ndryshimi +/-</i>
Nga shitjet	294,955,620.34	1,012,194,295.61	(717,238,675.27)
Te tjera	-	-	-
Kosto e shitjeve			
Shitje mallra e sherbime	253,296,071.66	754,959,447.03	(501,663,375.37)
Fitimi nga veprimtaria	41,659,548.68	257,234,848.58	(215,575,299.90)
Interesa te fituara Neto	114,885.43	27,961.68	86,923.75
Diferenca kembimi Neto	(13,798,680.23)	(16,209,243.88)	2,410,563.65
Te tjera financiare	-	-	-
Fitimi Bruto	27,975,753.88	241,053,566.38	(213,077,812.50)
Shpenzime te pazbritshme	2,709,559.45	4,352,416.04	(1,642,856.59)
Baza llogaritjes se Tatim Fitimit	30,685,313.33	245,405,982.42	(214,720,669.09)
Tatim Fitimi 15%.	91,803.00	740,149.00	
Tatim Fitimi 15%.	4,602,797.00	36,810,897.36	(32,208,100.36)
Fitimi Netto per Vitin 2018	23,372,956.88	204,242,669.02	(180,869,712.14)

Te ardhurat e ushtrimit kane ardhur nga shitja e punimeve dhe sherbimeve .

Ne shpenzimet ushtrimore jane perfshire kostoja e mallrave, furniturat e ndryshme,shpenzime te tjera,taksat ne kosto,pagat e sigurimet ,amortizimi i Aktiveve Afatgjata Matariale e Jomateriale.

Fitimi nga veprimtarite e Shfrytezimit eshte rregulluar me rezultatin financiar neto i cili perben Fitimin bruto ose Fitimin paratimor te vitit ushtrimor.

Baza e fitimit tatimor eshte rezultat i fitimit paratimor ne vleren duke i shtuar shpenzimet jofiskale.Tatim fitimi faktik i vitit 2018 eshte llogaritur ne lek.Fitimi neto per vitin ushtrimor mbetet ne vleren 23,372,956.88 lek. .

Tirane ,Mars 2019 .